



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 204, datë 24.12.2024

**PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË SHOQËRISË AUDITUESE, PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES
FINANCIARE, PËR VITIN 2024**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e kriterëve të përzgjedhjes së shoqërisë audituese, për auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për vitin 2024, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti Operacional, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI

Kriteret e përzgjedhjes së shoqërisë audituese nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si më poshtë:

- a. Të jetë i licencuar apo i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë;
- b. Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titull profesional “Auditues Ligjor”;
- c. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjerë financiare apo autoritete rregullatore financiare që aplikojnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);
 - c/1. Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore.
- d. Të mos ketë konflikt interesash me subjektin që auditon, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”;
- e. Të mos jetë subjekt i parashikimeve të nenit 55, të të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, sipas afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- f. Të paktën njëri nga anëtarët e grupit të auditimit të ketë fituar titullin ACCA/CFA.